

## AKTI I THEMELIMIT

### I

## SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “LEXA” SH.P.K.

Themeluesi qe nenshkruan me poshte si vijon:

- 1) Z. Kadir Gökhan ÇELIK, shtetas turk, i datëlindjes 29.06.1992, i biri i Suleyman dhe Tulay, lindur në Afyonkarahisar / Turqi dhe banues në Tirane, mbajtës i pasaportës turke me Nr. U22378694, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar. Dukeqenese eshte shtetas turk dhe nuk kupton gjuhen shqipe prezent ne momentin e leximit dhe neshkrimit eshte perkthyesi Zurtar i Gjuhes Turke Ilirjan Shkrela identifikuar me nr personal H50223028E.

Qe ne vijim do te quhet Ortaku i Shoqerise “LEXA” SH.P.K.

Sot me date 31.07.2023, bazuar ne vullnetin e tij te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, vendosi te themeloje Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

### Kreu I

#### OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

##### Neni 1

##### Objekti i shoqerise

Shoqeria “LEXA” SH.P.K., ka si objekt veprimtarie:

1. Programime kompjuterike
2. Aktivitetet konsultuese në fushën e teknologjisë së informacionit
3. Kontrolli dhe mirembajtje e pajisjeve kompjuterike
4. Shërbime të tjera të teknologjisë së informacionit
5. Aktivitetet e agjencive të udhëtimit
6. Aktiviteti i operatorit turistik
7. Shërbimet dhe aktivitetet e tjera të rezervimit që lidhen me to
8. Prodhimi, shitje - blerje te sherbime qe kane lidhje me objektin e veprimtarise se saj.

10. Import eksport ne Industrine e Automobilave dhe te tregtimit te gjitha llojeve te produkteve.
11. Marrja pjese neper ankande dhe tendera, si dhe te beje sherbime qe kane lidhje me objektin e veprimtarise se saj.
12. Pregatitja e projekte investuese dhe trajnime si dhe t'i menaxhoje ato.
13. Shitblerje e pasurive te luajtshme apo te paluajtshme, mjeteve te transportit, makinerive, automjeteve t'i marre ose t'i leshoje me qera, te marre pjese ne tenderin e tyre, si dhe te beje ndertime, rikonstruktive, rregullime, sherbime, etj., apo te transferoje te palet e tjera punet e tyre, me pakice dhe shumice.
14. Tregtim me pakice dhe shumice, ne format e parashikuara dhe te lejuara nga legjislacioni shqiptar.
15. Shoqeria, mund te kryeje per permbushjen e qellimeve te saj cdo lloj operacioni tregtar, mund te vendose pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, t'a hipotekoje kete pasuri ne rregjistrin e pasurive te paluajtshme ne emer te saj.
16. Mund te hyje ne tratativa dhe biznese me shoqeri te tjera qe kane te njejtin objekt veprimtarie per te realizuar fitime ne fushat e permendura ne kete nen.
17. Shoqeria, per te realizuar qellimin e saj, perdor te drejttat e pronesise, te mallrave te luajtshme dhe te paluajtshme, brenda dhe jashte vendit, ushtron veprimtari te ardhure dhe kursimi, krijon pengje dhe ipotekim mbi keto, perfiton, krijon, shlyen dhe ndan cdo lloj te drejte materiale, qeraje apo te drejta te mallrave te luajtshme dhe te paluajtshme.
18. Perfitoje, transferoje, te marre apo jape me qera, te bleje dhe shese, si dhe te kontraktoje, te drejten e markes, patentes, licences, dhe te drejttat e tjera qe jane te ngjashme me keto.
19. Shoqeria, sic mund te ushtroje punet qe tregohen ne objektin e veprimtarise se saj, brenda dhe jashte vendit, ashtu edhe mund te marre pjese, te perfitoje apo te transferoje nga/te palet e tjera, mund te marre pjese ne kapitalet e personave juridike dhe fizike, te vendit apo te huaj, te krijuar ose qe krijohen me qellim tregtie, industrie, etj., ne lidhje me keto fusha.



## Neni 2

### Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise

1. Ortaku vendosi qe shoqerine t'a emertoje "LEXA" SH.P.K.
2. Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga e Kavajes, (prane Godines se Dhomes se Tregtise dhe Industrise, Tirane) Pallati i Firmes Mezuraj, me Nr. Pasurise 2/98/ND+1-9, Zona Kadastrale 8380, Kati 7, Apt. Nr. 40, Tirane / Shqiperi.
3. Shoqeria mund te krijojte qendra sekondare, dege, zyra perfaqesimi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

## Neni 3

### Forma Juridike

1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi
2. Me vendim te ortakut mund te ndryshoje formen juridike te Shoqerise, ne qofte se ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast Ortaku do te pershtase Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar, ne organet kompetente shqiptare.
3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.
4. Shoqeria do te kete vulen e saj.

## Kreu II

### TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

## Neni 4

### Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakeve

1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.
2. Shoqeria gezon te drejten te krijojte pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne nje shoqeri tjetere ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.

5. Ortaku merr pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vet ose nepermjet perfaqesuesve te tij.
6. Ortaku ka te drejte te marre te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

#### **Neni 5**

#### **Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar.

### **Kreu III**

#### **KAPITALI THEMELTAR**

#### **Neni 6**

#### **Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte **100.000 (njqind mije) leke**.

Ai eshte i ndare ne **1 (nje) pjese (kuote)** me vlere **100.000 (njqind mije) leke**.

**Ortak i vetem i shoqerise eshte:**

- 1) **Z. Kadir Gökhan ÇELIK**, zotërues i **1 (nje) kuote** me vlere **100.000 (njqind mije) leke**, qe perben **100 %**, të kapitalit të themeltar shoqërisë.

### **Kreu IV**

#### **PERSONALITETI JURIDIK**

#### **Neni 7**

Shoqeria fiton personalitetin juridik ne ditën e rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar ne Qendren Kombetare te Biznesit ne Tirane, si dhe fillon veprimtarine e saj me marrjen e licences te ushtrimit se veprimtarise.

### **Kreu V**

#### **ADMINISTRIMI**

#### **Neni 8**

1. Shoqeria do te administrohet nga dy administratore te cilet jane **Z. KENAN TURAN** dhe **Z. BERK KÜÇÜKALTUN**, te cilet te dy se bashku ose vec e vec do te perfaqesojne shoqerine ne marrredheniet me te tretet dhe do t'i ushtrojne detyrat dhe kompetencat e tyre per nje periudhe **5 (pese) vjecare** dhe me te drejte rizzgjedhje.

2. Administratorët mund t'i delegojne kompetencat e tij me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.

## Kreu VI

### DISPOZITA TE TJERA

#### Neni 9

1. Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i mbetet Ortaket te saj.
2. Ky Akt redaktohet dhe nenshkruhet ne 3 (tre) kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore.
3. Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te shoqerise.

Autorizohet Ilirjan Shkrela, i biri i Xhemalit, i datelindjes 23.02.1975, banues ne Tirane, dhe/ose Denis Muka, i biri i Ilias, i datelindjes 06.01.1989, banuese ne Tirane, dhe/ose Aida ALBAYRAK, e bija i Halitit, e datelindjes 22.02.1979, banuese ne Tirane, qe te kryejne vec e vec ose se bashku te gjithe veprimet e nevojshme prane Qendres Kombetare te Biznesit, per pergatitjen e dokumentacionit te nevojshem, aplikimin per regjistrimin e shoqerise dhe depozitim apo terheqjen e cdo dokumentacioni te nevojshem te saj, apo cdo veprim tjeter te nevojshem ne funksion sa me siper.

### ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE "LEXA" SH.P.K.

Z. Kadir Gökhan ÇELİK

Përkthyesi Gjyko

Turke

(Nje kopje shkak)

Kadir Gökhan ÇELİK



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER MAJLINDA L. BEGAJ



DATE 31/07/2023

NR REP 1351

1/2

VËRTETIM NËNSHKRIMI

31 JUL 2023

Sot, më datë 31 JUL 2023, para meje Notere MAJLINDA L. BEGAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, BLV"BAJRAM CURRI", ND.170, H.24, AP.1, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES:

**Kadir Gokhan Çelik**, atësia Suleyman, amësia Tulay, shtetas Turk, lindur në Afyonkarahisar dhe banues në Turqi, me adresë Turqi, lindur më 29/06/1992, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte Biometrike nr. U22378694 dhe nr. personal U22378694, .

Subjekti i mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Noteres, "Akt Themelimin e Shoqerise Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar "LEXA" SH.P.K", bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE

MAJLINDA L. BEGAJ